Kronikë

Tiranë/ I shpallur në kërkim për vrasjen e 38-vjeçarit në Durrës, arrestohet 30- vjeçari! Iu gjet drogë e dokumente false

Një 30- vjeçar i quajtur Gabriele Peqini është vënë në pranga nga policia e Tiranës ditën e sotme, pasi ishte shpallur në kërkim për tentativë vrasje.

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Redaksia
6 Gusht, 09:16 | **Përditësimi: 6 Gusht, 10:40**

Share

Një 30- vjeçar i quajtur Gabriele Peqini është vënë në pranga nga policia e Tiranës ditën e sotme, pasi ishte shpallur në kërkim për tentativë vrasje.

Sipas policisë, 30- vjeçari është me rekorde të shumta kriminale dhe rrezikshmëri të lartë shoqërore, ndërsa në vitin 2022 plagosi në Durrës, 38- vjeçarin Daniel Bushin.

Gjatë arrestimit policia i gjeti drogë e dokumente false.

LEXO EDHE:
Kryeparlamentarja e Sllovenisë uron Spiropalin: Jam e bindur se do zbulojmë rrugë të reja për të rritur bashkëpunimin

Njoftimi i Policisë:

Tiranë

Finalizohet operacioni policor i koduar "Flagranca" nga shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 6 në bashkëpunim me ato të Seksionit të Forcës së Posaçme të Operacioneve Speciale dhe Sektorin për Hetimin e Narkotikëve në DVP Tiranë.

Kapet dhe arrestohet një shtetas i shpallur në kërkim për tentativë vrasje, me rekorde të shumta kriminale dhe rrezikshmëri të lartë shoqërore.

30-vjeçari qarkullonte i armatosur, me mjete identifikimi të dyshuara të falsifikuara si dhe posedonte lëndë të dyshuara narkotike.

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 6 në bashkëpunim me ato të Seksionit të Forcës së Posaçme të Operacioneve Speciale dhe Sektorin për Hetimin e Narkotikëve në DVP Tiranë, në vijim të punës për lokalizimin, kapjen dhe vënien përpara përgjegjësisë penale të shtetasve të shpallur në kërkim, bazuar dhe në informacionet e siguruara në rrugë operative, për vendndodhjen e një shtetasi me rrezikshmëri të lartë shoqërore të shpallur në kërkim për tentativë vrasje, i cili qarkullonte i armatosur, organizuan dhe finalizuan operacionin policor të koduar "Flagranca".

Si rezultat i këtij operacioni, në aférsi të mbikalimit te Casa Italias, është lokalizuar dhe arrestuar shtetasi Gabriele Peqini, 30 vjeç.

Ky shtetas ishte shpallur në kërkim pasi Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës i ka caktuar masën e sigurimit personal "Arrest në burg", për veprën penale "Vrasja me dashje", mbetur në tentativë.

30-vjeçari, në vitin 2022, në Durrës, për motive të dobëta, ka tentuar të vrasë me armë zjarri një shtetas.

Gjatë kontrollit fizik shërbimet e Policisë i gjetën dhe sekuestruan një armë zjarri pistoletë me krèhra e municion luftarak, dy mjete identifikimi të dyshuara të falsifikuara dhe sasi lënde të dyshuar narkotike.

Materialet i kaluan Prokurorisë.

S.B/Shqiptarja.com

TAG: gabriele peqini | Tirane

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Himara, i kujt është faji që 6 mijë votues ishin me karta të skaduara?

Institucioneve | Opozitës | Qytetarëve

Lajme të tjera

Begaj pret të Ngarkuarën me Punë të SHBA në Tiranë: Mirënjohje për kontributin tuaj
5 Gusht, 11:49

Tiranë/ Shitje narkotikësh dhe dhunë në familje, 6 në pranga
5 Gusht, 08:49

Tiranë/ Ishte në zonën e ajrimit, i paraburgosuri i IEVP-së 'Jordan Misja', humb jetën pas arrestit kardiak
4 Gusht, 18:54

Operacioni 'Plumbi i Artë 2'/ Arrestohet në Kosovë, Arben Lamçja! Pjesë e grupit të Çopjave si vrasës me pagesë
4 Gusht, 16:32

8 projektet e reja me kulla deri në 65-100 kate në horizontin e Tiranës
4 Gusht, 12:57

Ermonela Jaho koncert në Teatrin e Operas dhe Baletit, Veliaj i dhuron Kullën e Sahatit: Mirënjohës që je imazh i Shqipërisë moderne
4 Gusht, 11:47

Shkroi për trafikun e armëve drejt Britanisë, ambasadori shqiptar në Britani: Titulli i 'The Sun' keqinformues
3 Gusht, 18:11

Kremtohet 32 vjetori i fronëzimit të Kryepeshkopit Anastas
3 Gusht, 14:35

Veliaj inspekton punimet te Teatri i Ri: Në 30 muaj po bëjmë atë që humbëm në 30 vjet
3 Gusht, 12:55

Media britanike 'The Sun': Armët e kapura për në Angli, trafikoheshin nga një grup në Tropojë me lidhje në Londër
3 Gusht, 11:58

Shiste kanabis të ndarë në doza në Tiranë, arrestohet 33-vjeçari
3 Gusht, 10:07

Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës thyen një tjetër rekord në korrik 2024
2 Gusht, 18:43

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje